



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 74

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Prishtinë, më 1 korrik 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi, Liburn Aliu.

Munguan: Sasha Gjokiq.

I ftuar: z. Ferid Agani, ministër i Shëndetësisë së Republikës së Kosovës.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit; Xheneta Sopjani, praktikante; Qemajl Hasani, Gani Shabani dhe Musa Rexhaj nga Ministria e Shëndetësisë.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.06.2013;
3. Takimi me ministrin e Shëndetësisë, z. Ferid Agani;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 24.06.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së e datës 24.06.2013.

3. Takimi me ministrin e Shëndetësisë, z. Ferid Agani

Fikrim Damka- Tha se sot kemi ftuar ministrin z. Agani për të diskutuar për Projektligjin për transplantimin e organeve, i cili është tërhequr nga ministri, si dhe për vazhdimin ose ndalimin e shqyrtimit të Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, duke pasur parasysh që këto dy projektligje kanë ngjashmëri. Gjithashtu, do të bisedojmë edhe për shkresën e Ministrisë për rishikimin e buxhetit për vitin 2013.

Ferid Agani- Tha se sa i përket tërheqjes së Projektligjit për transplantimin e organeve, kemi pasur konsultime me ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe kemi ardhur në përfundim se, duke pasur parasysh vonesat për miratimin e Ligjit të shëndetësisë dhe fillimin e zbatimit të reformës në sistemin shëndetësor, e cila ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të institucioneve shëndetësore për ofrimin e shërbimeve më cilësore, në mesin e tyre edhe transplantimin e organeve. U krijua një opinion se nëse ligji miratohet dhe hyn në fuqi, dhe lejohet fillimi i zbatimit të transplantimit të organeve në institucionet të cilat i plotësojnë kushtet ligjore, atëherë sistemi publik shëndetësor do të ishte në pozitë të hendikepuar, sepse ne jemi në fazën e nxjerrjes së akteve nënligjore për funksionalizimin e shërbimit spitalor dhe klinik universitar të Kosovës. Duke pasur parasysh dispozitën ligjore që barazon sektorin publik dhe privat në shëndetësi, nëse do të insistonim të lejonim transplantimin, do të kufizohej vetëm në sektorin publik dhe publiko-privat, do hapnim mundësi për procedura ligjore kundër shtetit, pse ndalojmë diçka që është e lejuar me Ligjin e shëndetësisë. Në bazë të këtyre rrethanave, e kemi marrë edhe vendimin për tërheqjen e projektligjit, në mënyrë që të krijojmë parakushte për transplantimin e organeve dhe t'u ikim dezinformimeve dhe manipulimeve, duke marrë parasysh realitetin politik në të cilin gjendemi.

Shpresoj që gjatë vitit, ta kthejmë projektligjin në Kuvend, në versionin përfundimtar.

Sa i përket Projektligjit për transplantim e indeve dhe qelizave, duhet të vazhdohet të punohet në të, sepse është një ligj i domosdoshëm.

Salihe Mustafa- Tha se pajtohem të vazhdojmë punën për Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave. Por, njëkohësisht, duhet ta harmonizojmë atë me Projektligjin për transplantimin e organeve. Mendoj se gjatë punës në grup punues, duhet të jetë i pranishëm edhe eksperti, që ka punuar në Projektligjin e transplantimit të

organeve, por edhe eksperti i Projektligjit për transplantimin e indeve dhe qelizave, për t'i koordinuar disa çështje që janë të ndërlidhura mes veti, si p.sh. në Projektligjin për transplantimin e organeve është Qendra Shtetërore e Transplantimit të Organeve, ndërsa te transplantimi i indeve dhe qelizave, është Qendra e Koordinimit dhe Transplantimit të indeve dhe qelizave.

Ferid Agani - Propozoi që amendamentet e propozuara nga Komisioni për Projektligjin për transplantimin e organeve, të vihen në dispozicion si Ministri, që të aktivizojmë menjëherë grupin punues, i cili ka punuar në atë projektligj dhe të fillojë analizën e propozimeve e t'i inkorporojë ato. Qëllimi ka qenë që të jetë një qendër shtetërore për transplantime, me regjistra të veçantë për transplantimin e organeve dhe për transplantimin e indeve dhe qelizave. Dhe, këtu ne mund të ofrojmë një ndihmë teknike për të realizuar këto koordinime. Besoj që në fillim të javës së ardhshme do të kryhet kjo.

Time Kadrijaj- Tha se këto grupe punuese është dashur të bashkëpunojnë që në fillim, por megjithatë është ide e mirë që edhe tash të punojnë dhe të dalin dy ligje të mira.

Ferid Agani- Tha se këto dy grupe kanë punuar bashkë, sepse problematika është përafërsisht e njëjtë, por të jetë e qartë se bëhet fjalë për dy ligje speciale, që nuk ka këtu ligj bazë.

Flora Brovina- Tha se bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit dhe ministrive përkatëse, ekziston. Ne gjatë gjithë kohës së amendamentimit, kemi pasur prezent në mbledhje ekspertin e Ministrisë që ka përpiluar ligjin në fjalë. Ne kemi punuar në Projektligjin për transplantimin, ndërsa ju e keni tërhequr atë duke e shfrytëzuar të drejtën tuaj, por mënyra se si ju po mundoheni ta ndryshoni ligjin, nuk është në rregull.

Ferid Agani- Tha se është çështje e procedurës ligjore, sepse në momentin kur e tërheqim projektligjin, atëherë ai projektligj duhet të kalojë në Qeveri, prapë prej fillimit. Atë që e thashë, është vetëm në aspektin funksional dhe të bashkëpunimit.

Fikrim Damka – Tani do bisedojmë për shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2013.

Ferid Agani- Tha se qëllimi i Projektligjit për rishikimin e buxhetit 2013, është që të arrihet një shfrytëzim më efektiv i buxhetit ekzistues, nëpërmjet alokimeve- rialokimeve nga një pozitë buxhetore, në pozitën tjetër buxhetore. Buxheti i vitit 2013 ka qenë i miratuar në bazë të legjislacionit të vjetër. Shumë prej projeksioneve reformuese të sistemit shëndetësor, nuk mund të jenë pjesë e atij legjislacioni, për shkak se ligji në fuqi i shëndetësisë e ka ndaluar një gjë të tillë. Prandaj, ne i kemi disa kërkesa specifike, që një pjesë e tyre kanë të bëjnë me rialokimet brenda vijave buxhetore të Ministrisë, që besoj se nuk do të duhej të ishte kaq problem i madh, ashtu siç e ka bërë Ministria e Financave.

Një nga kërkesat kryesore, është çështja e transferimit për pagesë të performancës. Mendoj që kjo duhet të përkrahet nga Komisioni, sepse menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit të shëndetësisë, më 22 maj 2013, ne kemi nxjerrë udhëzimin administrativ që parasheh Ligji për skemat stimulative të performancës. Ky udhëzim ka hyrë në fuqi që nga java e kaluar. Në udhëzimin administrativ janë të parapara, në mënyrë të saktë, procedurat dhe rrethanat e shfrytëzimit të këtyre mjeteve:

• Për spitale	1.599.999,99
• Për QKUK-në	1.241.460,86
• Për Mjekët në specializim	886.862,74
• Për TMJIPSH	600.000,00
• Për kategorinë e shërbimeve komunale	936.922,00

Kërkesa tjetër e veçantë është si rezultat i përgjigjes ndaj situatës epidemiologjike me sëmundjet hemorragjike në vend, përmes një këshilli ndërministror, i cili do të zhvillonte aktivitete në zbatimin e një plani strategjik, që do të miratohej në Qeveri. Si draft, ky plan është miratuar në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, por kjo strategji duhet të kalojë edhe nëpër ministritë e linjës, e edhe në Qeveri. Kjo strategji për vitin 2013, e ka koston 546.000 euro .

Time Kadrijaj- Si Komision, ne do të përkrahim çdo iniciativë, por dua të di nëse për mjetet për pagesën e performancës, a do të bëhet tërheqja nga linja buxhetore e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve?

Ferid Agani- Tha se nuk bëhet fjalë për marrje të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, bëhet fjalë për programin nr. 719, për Agjencinë Komisionare për Kujdesin Shëndetësor, ndërsa këto mjete nuk janë pjesë e asnjë buxheti shëndetësor. Vlen të theksohet se këto mjete nuk kanë mundur të shfrytëzohen, sepse nuk ka qenë ligji i Shëndetësisë në fuqi.

Flora Brovina- Tha se nuk e kam të qartë pse Ministria e Financave e ka kundërshtuar kërkesën, kur këto mjete kanë qenë të ndara për performancë.

Kur është fjala për epideminë e shfaqjes së rriqrave, duhet të reagohej më shpejt. Kujdesi nuk matet me pickimet nga rriqrat, por nga numri i vdekjeve. Me keqardhje të madhe e them, por arsyetimi publik nuk ka qenë i mirë. Performanca e Institutit nuk ka qenë e mjaftueshme.

Ferid Agani- Tha se sipas të dhënave epidemiologjike, mortaliteti nga ethe është 0.05 % në vend, sipas parametrave ndërkombëtarë, mortaliteti është më i ulët se në vendet tjetra të rajonit. Infektiviteti i rriqrave me virus, është çështje e cila është duke u studiuar nga Instituti Kombëtar.

Kjo strategji për të cilën po flasim ne, është dizajnuar në vitin 2007, por nuk ka pasur mbështetje financiare. Në vitin e kaluar, ne kemi ndarë 20 mijë euro për Komunën e Malishevës dhe të Rahovecit, ndërsa këtë vit kemi ndarë 160 mijë euro.

Flora Brovina- Tha se është e nevojshme të bëhen edhe krahasime me vendet tjera të vendeve epidemiologjike, në vendet e ish- Jugosllavisë, sepse këto krahasime do ta lehtësonin vlerësimin e performancës së ekipeve tona në vend.

Liburn Aliu- Pyeti: Pse Ministria e Financave nuk e ka aprovuar këtë rialokim?

Ferid Agani- Tha se edhe në mbledhjen e Qeverisë e kam bërë këtë pyetje, por nuk kam marrë përgjigje. Por, supozoi që ka bazë ligjore, sepse në ditën kur është miratuar rishikimi i buxhetit, nuk ka qenë në fuqi udhëzimi administrativ për performancën.

Time Kadrijaj- Pyeti: Marrëveshjen që e keni lidhur me Ministrinë e Drejtësisë dhe këto transferime që janë paraparë, a kalojnë punëtorët shëndetësorë të Shërbimit Korrektues në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë?

Sa i përket investimeve kapitale në komuna, nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Kaçanik kam informatë që janë bërë shumë kërkesa në Ministrinë e Shëndetësisë për ndërtimin e kësaj qendre, a është bërë diçka?

Ferid Agani- Sa i përket bartjes së shërbimit korrektues nën kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë, është obligim që del nga Ligji i shëndetësisë. Kjo do të finalizohet me nxjerrjen e udhëzimit administrativ. Të gjithë punëtorët që janë në shërbimet shëndetësore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, dalin nën kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria do të krijojë një departament të veçantë. Edhe buxheti, edhe punëtorët do të barten në Ministrinë e Shëndetësisë

Sa i përket Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kaçanik, është në një gjendje të mjerueshme, si dhe Spitali Rajonal në Ferizaj. Ne si Ministri, jemi të përkushtuar në rregullimin e kushteve në këto spitale, në bazë të ndihmave të donatorëve. Këtë vit do të fillojmë me punët në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kaçanik.

Salihe Mustafa- Tha se ne do t'i përkrahim kërkesat për performancën. Por dua të di nëse ka mjete për implementimin e planit për mjekët e posa diplomuar , ku sipas ligjit obligoheni që mjekët e posa diplomuar të inkuadrohen nëpër qendra të mjekësisë familjare. A i keni identifikuar nevojat nëpër komuna?

Ferid Agani- Tha se sot në Ministrinë e Shëndetësisë janë vetëm 40 mjekë specialistë që kërkojnë punë. Gjithashtu, e kemi ulur shumë presionin, janë punësuar 170 mjekë specialistë. Në këtë fazë, ne jemi të përqendruar në 270 mjekë specialistë me vetëfinancim. Në vitin e ardhshëm, mjekët të cilët e përfundojnë fakultetin dhe janë të licencuar, vitin e parë do të punësohen në kujdesin parësor dhe ata që duan të shkojnë në viset rurale, do të punësohen menjëherë edhe pa e përfunduar specializimin.

Bahri Thaçi- Tha se Ministria e Shëndetësisë ka bazë ligjore që ta mbështetë financimin e performancës.

Sa i përket gjendjes epidemiologjike në vend nga pickimi i rriqrave, mendoj që shëndetësia është padrejtësisht e atakuar nga mediat, sepse fajin më të madh e ka Ministria e Bujqësisë, e cila e ka për obligim që më së paku ta bëjë lëvrimin e atyre tokave, sepse me lëvrim pengohet shumimi dhe bartja e tyre.

Ferid Agani- Tha se edhe në Komisionin për Bujqësi, është diskutuar kjo çështje. Sa i përket punës së specializantëve, unë kam biseduar me drejtorët e shërbimeve komunale, për të parë se ku janë nevojat.

Shfrytëzoj rastin që t'ju informoj edhe për politikat e reja për barnat dhe materialin harxhues në Ministri. Një grup ekspertësh, në krye me Arianit Jakupin, kanë përpiluar një kategori të re të listës esenciale të barnave. Kjo listë është ndarë në tri kategori, bazuar në metodologji shkencore: e *ashtuquajtura ven analiza dhe abc analiza, ven analiza*, ndarja sipas rëndësisë së vitalitetit të barnave dhe materialit harxhues, ku ndahet në barna vitale, esenciale dhe joesenciale. Kjo listë e ndarë, është analizuar sipas çmimeve se sa mund të jetë kjo e mbuluar nga Qeveria. Po ashtu, kanë arritur në një listë të preparateve vitale, që ka koston 22 milionë euro, e cila do të mbulohet 100 %, kurse zbatimi i saj pritet të fillojë tash në korrik.

Liburn Aliu- Tha se disa specializantë e kanë të vështirë ta vazhdojnë studimin për një pjesë të specializimit që duhet ta kryejnë jashtë vendit, nga ana tjetër, Komiteti specialistik e ndalon. Si mund të zgjidhet kjo çështje, sepse ata janë të paguar, koha po ju kalon dhe nuk po shkollohen?

Ferid Agani- Tha se kemi pasur takim me përfaqësues të Komitetit, sepse kemi pasur ankesa nga specializantët. Farmacia është një prej problemeve të së kaluarës. Nuk mund të kryhet specializim, pa e përfunduar programin e shkollimit. E vetmja mundësi është jashtë vendit.

Problemi është se specializantët kanë menduar se këtë pjesë të stazhit specialistik, mund ta kryejnë në Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, në laboratorin e tyre.

Flora Brovina- Pyeti ministrin: A keni pasur ndonjë kërkesë për krijimin e spitalit të Prishtinës ?

Ferid Agani- Tha se zyrtarisht nuk kemi pasur asnjë kërkesë nga Komuna e Prishtinës. Nuk është reale që Prishtina të ndërtojë një spital të qytetit. Faktikisht, QKUK-ja është spital i qytetit. Ne kemi nevojë për një qendër klinike universitare të nivelit të tretë. Por, në momentin që ndërtohet qendra emergjente e re, qendra ekzistuese i mbetet kryeqytetit. Kemi bërë projektin e Qendrës Emergjente me kosto prej 30 milionë eurosh, e kemi dërguar në Bankën Islamike për Zhvillim, Fondin Saudit për Zhvillim dhe jemi duke pritur përgjigjen e Fondit Kuvajtian, ku kemi bërë kërkesë për një hua të butë, për 20 vjet, pa kamatë.

Fikrim Damka – Falënderoi ministrin Agani për pjesëmarrje.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi të përkrahë propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë për bartjen e buxhetit për pagesën e performancës.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka